



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. Jedinica Org. Unit	ARPL
Nr. i Faqeve Br. Stranika No. Pages	-04-
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	7337-2/19
Data: Datum: Date:	11.07.22
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalvog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	23.06.2022
REFERENC-Ë:	7337/19 - ARPL
PËR/ZA/TO:	„ Burimi B ” SH.P.K, Arbanë, Prizren
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Servet SPAHIU, Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së, Z. Naser HAFIZI- Zëvendësues i Udhëheqësit të ARPL-së
NGA/OD/FROM:	Sylejmon LATIFI-Zyrtar Përgjegjës për Akte Ujore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim – Leje Ujore -Shfrytëzim

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën me Nr. të protokollit: 7337/19 për shfrytëzim të ujit nga K.R.U “Radoniqi-Dukagjini” për Seperacionin –Prodhim betoni “Burimi B ” SH.P.K, ” Arbanë, Prizren, dhe ka vendosur Vendimin për Leje Ujore, pas plotësimit të dokumentacionit të bashkangjitur kësaj shkresë përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

Datë: 23.06 .2022

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencie të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, shtojcës 1 pika 10 të Rregullorës (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L -147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitive ligjore të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

**V E N D I M**

**APROVOHET** kërkesa e palës "Burimi B" SH.P.K, Arban, Prizren për **LEJE UJORE** për shfrytëzimin e ujit nga K.R.U "Radoniqi-Dukagjini" për prodhim të betonit, sipas kushteve vijuese:

1. Uji për shfrytëzim do të jetë K.R.U "Radoniqi-Dukagjini"  
 $Q_{max} = 3.42/s$  (tre pikë katërdhjetë e dy litra për sekondë) në piken me koordinata:  $X = 7\ 475\ 020$  ;  $Y = 4\ 678\ 203$  , sipas kushteve vijuese:
2. Pala përmes regjistrimit me anën e ujëmatësve, duhet të evidentoj: Prurjen mesatare ditore (l/s), sasinë ditore ( $m^3/ditë$ ), dhe sasinë vjetore ( $m^3/vit$ ). Për sasinë e shfrytëzuar pala obligohet që për çdo gjashtë muaj të informoj me shkrim ARPL/MMPHI, nga momenti i marrjes së lejes ujore;
3. Nr. Serik i ujëmatësit të kyqur në kanal in e ujitjes , duhet prezantuar në ARPL/MMPHI, në afat prej 15 dite nga pranimi i këtij vendimi, si dhe për



ndërrimin e mundshëm të tije, duhet informuar Organi përgjegjës, që e ka lëshuar këtë vendimin;

4. Obligimi për kompensimin e ujit të shfrytëzuar, do të përcaktohet me aktvendim të posaçëm nga MMPHI, sipas Udhëzimit Administrativ në fuqi, për Strukturën e Pagesave të Ujit;
5. Për këtë pala obligohet të raportoj për perioda kohore të shfrytëzimit, sipas pikës 2 të këtij vendimi, mbi sasinë e shfrytëzuar të ujit të matur përmes Ujëmatësit, ashtu që të plotësohet kushti paraprak;
6. Afati i lëshimit të lejes ujore është 5 (Pesë) vite, me mundësi vazhdimi sipas kërkesës së palës;
7. Për vazhdimin e kohëzgjatjes së Lejes Ujore, bartësi është i obliguar që 2 (dy) muaj para skadimit të afatit të paraqes kërkesë për vazhdimin të lejes ujore;
8. Në rast se pala vendos, lidhur me rritjen apo zvogëlimin e shfrytëzimit, duhet të bëjë kërkesë për ndryshim të lejes ujore;
9. Leja ujore nuk mund të bartet tek personat e tretë, pa informimin e organit kompetent që e ka lëshuar të njëjtën;
10. Validiteti i Lejes Ujore pushon në rast të mos plotësimit të kushteve të kërkuara më sipër.

### Arsyetim

Zyrtarët përgjegjës, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin e ndërtimit, kanë shqyrtuar dokumentacionin e palës për aplikim për Leje ujore - shfrytëzim i ujit nga K.R.U "Radoniqi-Dukagjini" për Betonjeren -Prodhimi betoni, kontrat për shfrytëzim e ujit per ujitje, sipas kushteve vijuese. Dokumentacioni i kompanisë : Çertifikata e regjistrimit të biznesit - ARBK- „Burimi B” SH.P.K , Plani i situacionit me përpjesë të lexueshme 1:1000, Kopja e planit , Çertifikatë e pronësis, Leje për Aktivitete të Veçanta -750/ KPMM/2109, kontraten per qiran e patundeshmeri te noterizuar ,Pelqim Mjedisor nr.19/1793/1- ZSP.

Faturat e pagesave për: Kushte Ujore, Pëlqim Ujorë dhe Leje Ujore.



Andaj, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, akteve administrative të lëshuara nga organet kompetente, legjislacionit për ujërat për shqyrtimin e aplikacioneve për akte ujore është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr. 7337/19 - ZSP- 2022 Datë: 23.06.2022

Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komuna e Prizren;
- Arkivit të Ministrisë.

Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së



Servet SPAHIU